

RECENSA / VLERËSIME



Prof. Dr. NASER RAMADANI, MD, PhD, MPHE, CIEH, FCMIS.

**Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
10.000 Prishtinë
Republika e Kosovës**

Recension

mbi veprën madhore të Prof. Dr. EDUARD KAKARRIQI

Libri "SHËNDETI dhe SËMUNDJA: Vështrim Gjithëpërfshirës Filozofik dhe Epidemiologjik"

i shkruar nga **Prof. Dr. EDUARD KAKARRIQI**

trajton marrëdhënien komplekse midis shëndetit dhe sëmundjes, duke ofruar një perspektivë të thellë filozofike dhe epidemiologjike. Në këtë libër, autori ndihmon në kuptimin e konceptit të shëndetit përtej aspekteve mjekësore, si një nga vlerat tona më të rëndësishme, duke shqyrtuar faktorët social, mjedisor dhe kulturor që ndikojnë në shëndetin e individëve dhe popullsisë si mekanizëm dinamik i cili ndryshon gjatë jetës i cili duke devijuar nga baraspesha e funksionimit normal të trupit dhe mendjes, i shoqëruar me ndryshime strukturore, funksionale dhe psikologjike rrëshqet kah sëmundja me shkaktarët etiologjik të nduarnduarshëm.

Shëndeti dhe sëmundja: nga koncepti biologjik te kuptimi filozofik

Para lexuesve është ky libër i llojit të veçantë me mbi 1200 faqe, i cili prezanton një filozofi të re të menduarit në mjekësinë shqiptare.

Autori ua paraqet lexuesve thelbin e brendisë së veprës qysh në titullin e saj. Libri fillon me një strukturë të qartë: përkufizime themelore, nga një këndvështrim filozofik teorik dhe mënyrën se si epidemiologjia e kupton dhe e koncepton shëndetin dhe sëmundjen (epidemiologjia praktike e terrenit dhe klinike) në etiologji, diagnozë, prognozë dhe parandalim: duke filluar me përshkrimin e hollësishëm të shëndetit, konceptet e raportit shëndeti dhe sëmundja dhe raportet e shëndetësisë publike me mjekësinë klinike; duke përcaktuar mënyrën e të menduarit dhe vendimmarrjes në mjekësi nëpërmjet vlerave dhe normave; duke komunikuar e shkëmbyer përvojat mes kolegëve në njërin anë dhe pretendimet e njohurive mes profesionistëve dhe pacientëve; qasja holistike (shëndeti nuk pasqyrohet vetëm nga një organ ose parametër, por nga integrimi i këtyre komponentëve, treguesve, përcaktorëve, dimensioneve dhe koncepteve tjera në një dinamikë të tërësishme të jetës sonë me fuqinë e ndikimeve sociale, ekonomike, politike dhe mjedisore në

shëndet); deri tek filozofia bashkëkohore e ripërkufizimit të shëndetit dhe normalitetit ku çdo individ është unik dhe normaliteti është një koncept relativ.

Ky libër fton lexuesin që ta pasurojë mendjen me një ndërthurje të kuadrit teorik dhe praktik për të kuptuar shëndetin dhe sëmundjen jo vetëm si realitete biologjike, por edhe si kategori konceptuale, filozofike dhe shoqërore, i cili për një audiencë të specializuar është i dobishëm duke ndihmuar profesionistët të shohin përtej patologjisë klinike dhe të kuptojnë dimensionet biopsikosociale të pacientit, dimensionet epistemologjike dhe ontologjike.

Duhet posaçërisht theksuar se Profesor Kakarriqi diskuton se si filozofia mund të ndihmojë në formësimin e politikave shëndetësore dhe në përmirësimin e strategjive për parandalimin e sëmundjeve. Ai theksoi rëndësinë e një qasjeje multidimensionale për të adresuar sfidat shëndetësore, duke përfshirë edukimin, ndërgjegjësimin dhe qasjen ndaj shërbimeve shëndetësore dhe qasjen në hulumtimet, mbikëqyrjen, grumbullimin dhe analizën e të dhënave epidemiologjike.

Struktura akademike e veprës dhe qasja didaktike

Prof. Dr. Eduard Kakarriqi, në librin e tij "Shëndeti dhe Sëmundja: Vështrim gjithëpërfshirës filozofik dhe epidemiologjik", ka përshkruar konceptet e shëndetit dhe sëmundjes në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për publikun shqipfolës. Ai e ka arritur këtë duke u fokusuar në disa aspekte kryesore që e bëjnë tekstin mjaft informues dhe të qasshëm:

- Gjuha e thjeshtë dhe e qartë: Autori përdor një gjuhë të thjeshtë dhe terminologji origjinale shqipe dhe mjekësore të unifikuar për të përshkruar koncepte komplekse. Kjo e bën librin të kuptueshëm për një audiencë të gjerë, përfshirë edhe individ që nuk kanë një sfond të fortë në mjekësi ose shkenca shëndetësore.
- Struktura e organizuar: Libri është i organizuar në kapituj të strukturuar mirë, çka lehtëson navigimin nëpër tema të ndryshme duke trajtuar aspekte të veçanta të shëndetit dhe sëmundjes dhe duke e bërë informacionin më të lehtë për t'u absorbuar. Radhitja e çdo kapitulli është kryer sipas një logjike dhe është potencuar rëndësia që kanë ato për t'u kuptuar në mënyrë të lehtë dhe bindëse.
- Modulet edukative: Autori prezanton materiale në formë module, që ofrojnë informacion të detajuar mbi sjelljet pozitive dhe negative, modelet e shëndetit dhe parimet e ruajtjes së shëndetit. Kjo ndihmon lexuesit të ndajnë njohuritë në mënyrë të organizuar dhe sistematike.

- Shembuj praktik: Përdorimi i shembujve praktik dhe analiza të rasteve konkrete e pasuron tekstin dhe ndihmon për të ilustruar rëndësinë e normave shëndetësore dhe sjelljeve të shëndetshme në përditshmërinë e individëve duke rivlerësuar kujdesin për shëndetin individual e shëndetin e komunitetit në origjinë (Salutogjeneza).
- Shqyrtime filozofike dhe epidemiologjike: Kjo qasje filozofike ndihmon lexuesit të kuptojnë se shëndeti dhe sëmundja nuk janë thjesht fenomene biologjike, por ato janë të ndikuara gjithashtu nga faktorë socialë dhe mjedisorë. Kjo perspektivë gjithanshme është veçanërisht e rëndësishme për krijimin e politikave shëndetësore efektive.
- Informim mbi parandalimin: Libri thekson rëndësinë e parandalimit, duke përfshirë edukimin dhe ndërgjegjësimin lidhur me sjelljet që promovojnë shëndetin dhe ato që e dëmtojnë atë. Kjo qasje është e rëndësishme për ngritjen e vetëdijes në mesin e individëve dhe komuniteteve.
- Dimensionet psikologjike dhe sociale: Kjo është një nga fokuset e këtij libri, ku Kakarriqi shqyrton se si faktorët psikologjikë dhe socialë ndikojnë në shëndetin e individëve. Kjo ofron një këndvështrim më të gjerë mbi sëmundjen, duke e parë atë si një proces që prek më shumë se thjesht aspektet fizike.
- Literatura: Libri është pasuruar me të dhëna bashkëkohore me mbi 1.500 referenca, libra e tekste shkollore që reflektohen në të 46 kapitujt.



Prof. Dr. Eduard Kakarriqi

Qasja multidisiplinare dhe ndikimi në mendimin bashkëkohor mjekësor

Bazuar në përvojën mbi dyzet vjeçare në mjekësi dhe eksperiencën e gjatë në mësimdhënie universitare dhe në hulumtimet kërkimore-shkencore, autori ka ditur të bëjë strukturimin e librit për të gjitha kategoritë e lexuesve me një audiencë të gjerë duke vendosur kapitujt në një harmoni dhe lidhshmëri perfekte. Libri është konceptuar për si studentë të mjekësisë në të gjitha nivelet, studentët në master shkencor e profesional, studentët kandidat PhD, profesionistë të shëndetësisë, epidemiolog, filozof të mjekësisë ashtu edhe duke ofruar një përdorim të gjerë edhe në shkencat infermierike, menaxheriale, juridike, ekonomike, filozofike, psikologjike, biologjike si dhe profesionistët e shkencave politike dhe për këdo i cili është i interesuar të mësojë më shumë duke reflektuar mbi çështjet etike të ngritura nga mjekësia moderne.

Teksti ka rol pionier duke pasuruar gjuhën shqipe me një literaturë vendore në një fushë kaq të gjerë, ku zakonisht mbështetemi vetëm në libra të huaj.

Ky libër është një burim i rëndësishëm për ata që dëshirojnë të thellojnë njohuritë e tyre rreth shëndetit dhe sëmundjes, duke ofruar një perspektivë të pasur dhe të integruar, duke përfunduar kornizat moderne të të menduarit mbi shëndetin e sëmundjen dhe duke vendosur paradigmen shkencore dhe filozofike ku shëndeti dhe sëmundja nuk mund të reduktohen vetëm në biologji, por duhen parë në ndërveprimin e biologjisë, psikologjisë dhe faktorëve socialë i cili është sot modeli dominues në mjekësi, psikologji dhe shëndetësi publike. Shëndeti si një gjendje e padukshme, që ne e kuptojmë vetëm kur humbet (kur sëmuremi) është trajtuar jo thjeshtë mungesa e sëmundjes, por një ekuilibër i jetës që përfshin trupin, shpirtin dhe marrëdhëniet shoqërore.

Libri ka meritë të veçantë pasi ofron një perspektivë vendore dhe i fut lexuesit shqiptarë në panoptikum debati mbi shëndetin dhe sëmundjen duke e lidhur me traditën filozofike dhe shkencore ndërkombëtare duke e zgjeruar përdorimin e tij si literaturë bazë akademike, ku autori me një erudizëm të rrallë qet në pah epidemiologjinë si logjikë e të menduarit në mjekësi, ku konceptet themelore janë qasur në mënyrë multidisiplinare ndaj problemeve të parashtruara.

Autori frymëzon profesionistët shëndetësor që t'i qasen problemeve mjekësore në një dimension holistik të ndërlidhur me perin e kuq, për të përfunduar vendimmarrjen më cilësore profesionale dhe menaxheriale dhe zhvillimin e udhërrëfyesve dhe protokolleve moderne.



Ndikimi afatgjatë dhe vlera e veprës në mjekësinë shqiptare

Nga të gjitha që u përmendën dhe duke gjykuar nga përmbajtja e librit mund të them me bindje të plotë se autori, me mjeshtri të rrallë, ka ndezur reflektorët gjigant të “Atlantidës mjekësore”, duke ndriçuar thellësitë e njohurive të shëndetësisë publike.

Vepra mbetet e hapur: ajo mund të vazhdohet; mund të zgjerohet; mund të thellohet, ajo është vetë "fjalëkalimi në mjekësinë moderne të rimodeluar".

Duke pasur parasysh të gjitha kriteret shkencore, etike dhe profesionale, libri "Shëndeti dhe Sëmundja-Vështrim Gjithëpërfshirës Filozofik dhe Epidemiologjik" i autorit Eduard Kakarriqi padyshim do të mbetet gjatë në përdorim nga profesionistët mjekësor dhe lexuesit e të gjitha disiplinave si një libër referencë, manual praktik, udhërrëfyes, kompas klinik, mega vade mecum, ndërfaqe tërësore.

Autorit Prof. Dr Eduard Kakarriqi i dëshiroj jetë të gjatë e të shëndetshme, veprimtari krijuese të frytshme, e nga pena e tij të lërohen veprat me të cilat do të krenohemi ne dhe mjekësia shqiptare.

Prof. Dr. ALBAN YLLI, MD, MPH, PhD

Shef, Departamenti i Epidemiologjisë të Sëmundjeve Kronike dhe Performancës në Shëndet Publik, Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë

&

Pedagog efektiv, Departamenti i Shëndetit Publik, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë i Tiranës

Fantastike profesor!

E lexova librin dhe ndaj përshtypje të ngjashme me recensën e Profesor Naser Ramadani.

Alban

Dr. ARTAN SIMAKU, MD, PhD

Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive, Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë

&

Epicenter, Tiranë

Dobia Praktike, Risitë dhe Rëndësia në Shkallë Vendi – Fushat ku Mund të Përdoret Konkretisht e Librit **"SHËNDETI dhe SËMUNDJA: Vështrim Gjithëpërfshirës Filozofik dhe Epidemiologjik"**

Epidemiologjik"

me autor **Prof. Dr. EDUARD KAKARRIQI**

Përse duhet ky libër?

- Plotëson një mungesë që ka lënë gjurmë: lidh botën teorike të filozofisë së mjekësisë me praktikën e përditshme në epidemiologji, diagnozë, prognozë dhe parandalim.
- Përdor terma të qartë dhe të unifikuar: “shëndet”, “sëmundje”, “diagnostikim”, “parandalim” e “case definition” përkthehen në gjuhë që kuptohet dhe zbatohet në terren.
- I ndihmon profesionistët të marrin vendime më të mira: duke kuptuar më mirë konceptet, vendimarrja bëhet më e shpejtë, më e qartë dhe më e saktë — qoftë në spital, në shëndet publik apo në politikëbërje.

Çfarë sjell ndryshe?

- Ndërthurje teoriko-praktike unike: nuk kufizohet në ide të përgjithshme, por i lidh meurvejancën, skringun, tranzicionet demografike dhe menaxhimin e rasteve.
- Rend strukturor në procesin mjekësor: qartësim i hallkave nga etiologjia te parandalimi: etiognosis → diagnosis → prognosis → prevention.
- Fut etikën dhe cilësinë në diagnozë: ndihmon klinikistët të kuptojnë ndikimin e vendimeve të tyre, jo vetëm teknikisht por edhe njerëzisht.
- I trajton përkufizimet e rasteve si çelës i sistemit: ndihmon në ndërtimin e protokolleve, krahasimin e të dhënave dhe kontrollin e cilësisë.

- Salutogjeneza dhe OMICS: fut konceptet e reja si: faktorët mbrojtës dhe qasjet moderne të biologjisë molekulare në një kornizë të kuptueshme.

Vlera për Shqipërinë

- Unifikon terminologjinë dhe protokollet: për spitalet, qendrat shëndetësore dhe institucionet e shëndetit publik — i njëjti kuptim për të gjithë.
- Mbështet politikat dhe strategjitë kombëtare: për tranzicionin epidemiologjik, survejancën, depistimin dhe parandalimin.
- Rrit cilësinë e të dhënave: përkufizimi i qartë i rasteve dhe skicimi i mirë i studimeve ndihmojnë në ndërtimin e statistikave të besueshme.
- Përdoret në trajnim dhe mësimdhënie: si tekst për kurse pasuniversitare, programe trainimi dhe mastera në shëndet publik e epidemiologji.

Kush e përdor dhe në çfarë fushe?

- Shëndeti publik / epidemiologjia / mjekësia parandaluese – për dizajn studimesh, survejancë, analizë të të dhënave.
- Mjekësia familjare dhe spitalore – diagnozë, prognozë, ndërhyrje parandaluese dhe edukim shëndetësor.
- Infermieristikë dhe menaxhim shëndetësor – për ndërtimin e protokolleve të kujdesit dhe kontrollin e cilësisë.
- Politikëbërës dhe menaxherë shëndetësorë – për planifikim strategjik dhe alokim të burimeve.
- Akademikë dhe kërkues – si bazë për studime kërkimore, disertacione dhe analiza teorike-praktike.
- Bioetikë / filozofi mjekësore – për kurse ndërdisiplinore dhe debat mbi vendimmarrjen klinike dhe sociale.
- Biologë / shkencat e jetës – për lidhjen ndërmjet patogjenezës, faktorëve molekularë dhe praktikës klinike.
- Psikologë / punonjës socialë – për të kuptuar rolin e faktorëve psikosocialë në sëmundje dhe shëndet.
- Studentë të mjekësisë – si tekst bazë për mësimin e shëndetit publik, epidemiologjisë klinike, etikës mjekësore dhe mjekësisë me bazë në prova.
- Në stomatologji — jo vetëm për konceptet themelore, por edhe për zbatimin konkret në praktikën klinike, në edukim dhe në kërkim. E bën stomatologjinë pjesë të të njëjtës gjuhë dhe logjikë me mjekësinë e përgjithshme dhe shëndetin publik.

Si përdoret në praktikë?

- Për të ndërtuar protokolle e rrjedha pune: kapituajt për përkufizimin e rastit dhe depistimin ndihmojnë në organizimin e shërbimeve dhe raportimit.
- Për vendime të mire-informuara në praktikën klinike: lidh diagnozën, prognozën dhe parandalimin me të dhëna dhe etikë.
- Për skicimin dhe analizën e studimeve: ndihmon në ndërtimin e studimeve mbi incidencën, prevalencën, faktorët e rrezikut dhe modelet prognostike.
- Për ndërhyrje dhe edukim në komunitet: konceptet e salutogjenezës dhe promovimit të shëndetit janë të zbatueshme në terren.

Përfundimisht,

Ky nuk është thjesht një libër.

Është një manual pune, që ndërton urën midis teorisë dhe praktikës.

Tekst referencë që “përkthen” të filozofinë e mjekësisë në protokolle, indikatorë dhe veprim—në shërbim të praktikës klinike, terrenit, shëndetit publik dhe politikave shëndetësore.

Përkufizon, strukturon dhe drejton.

Dhe e bën në gjuhë që kuptohet dhe aplikohet.

Prof. Dr. MENTOR PETRELA,

MD, PhD, Chev LH, PU-PH Fr, WANS, IFAANS

Shef, Departamenti i Neurokirurgjise, Spitali Amerikan 3, Tiranë

I dashur Edi,

Libri yt më dha kënaqësinë që ke arritur t'i përmbledhësh mendimet pas një eksperience të gjatë.

Si ke arritur vetëm ti e di, por Churchill sapo përfundoi "Memoirs of the Second World War" tha "I killed the Monster".

Të them të drejten u bëra xheloz pozitiv, të lumtë.

Duket mundim i Sizifit, por ke realizuar një vademekum për profesionistët e shëndetit dhe jo vetëm.

Gërshetimi me filozofinë për të shpjeguar pikpyetjet që të kanë lindur, më kujton stilin e Georges Canguilhem në narrativën e tij "Le normal et le pathologique".

Shkrimi didaktik në shtjellimin e koncepteve e bën tërheqës për të gjithë kategoritë e interesuara.

Duke të uruar shëndet të përgëzoj për këtë arritje sfiduese.

Të përqafoj,

Menti

Prof. Asoc. Dr. GENTIAN STRONI, MD, PhD

**Shef, Departamenti i Lëndëve Paraklinike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,
Universiteti i Mjekësisë i Tiranës**

I dashur Prof. Edi,

Dua të falenderoj për këtë vepër që ju keni përfunduar, e cila është një gur themeli veçanërisht në rrugëtimin akademik të çdo mjeku.

Mënyrat e pasqyrimin të temave duke filluar nga faqja e parë e këtij libri voluminoz, përkojnë me shumë dimensione, ku secili lexues specifik dëshiron të gjejë veten, dhe, duke vazhduar leximin, vendos dijenitë e veta në përputhje me njohuritë e marra nga ky libër në skedare memorije, të cilat janë vështirë për t'u çrrënjësuar.

Kushdo mund të hapë kapitujt për të cilët është më tepër i interesuar, ndoshta pa kaluar gjithë materialin voluminoz, por të ndërtuar bukur me detaje shkencore në çdo fletë të tij.

Për mendimin tim dua ta konsideroj si një udhërrëfyes në aspektin e strukturimit (skeletonit të tij), në aspektin e elementeve të imta në të cilat secili prej nesh gjen veten duke thënë: 'unë e di këtë'; por pa ditur ta artikulojë qartë, ashtu sikurse ky libër e bën.

Një nga tiparet më të dallueshme të punës suaj në këtë punim madhor sa shkencor aq dhe didaktik është aftësia për të ndërthurur:

- epidemiologjinë,
- filozofinë e shkencës,
- sociologjinë e shëndetit,
- konceptet e ekosistemit njerëzor,
- dhe parimet e etikës kolektive.

Shëndeti, sipas analizës suaj të gjithanshme filozofike dhe epidemiologjike, nuk është thjesht mungesë sëmundjeje, por një realitet i ndërvarur, i ndikuar nga faktorë biologjikë, kulturorë, ekonomikë, mjedisorë dhe psikologjikë.

Ky interpretim është thelbësor për zhvillimin modern të epidemiologjisë shqiptare dhe për krijimin e një tradite të re të mendimit shëndetësor.

Duke shprehur përgëzimet e mia të sinqerta për këtë punim tepër të vlefshëm për mjekësinë shqiptare,

Me respekt,

Genti

Prof. Dr. GEORGINA KULI-LITO, MD, PhD

**Shefe, Shërbimi Universitar i Sëmundjeve Infektive, Departamenti Universitar i Pediatriisë,
Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë**

Përshtëndetje Edi,

Urime për librin voluminoz dhe shumë të nevojshëm në praktikën tonë.

Do ta krahesoja me " Biblën " për çdo pediatër dhe infeksionist.

Faleminderit për mundësinë që na jepni ta kemi në bibliotekën tonë.

Shumë faleminderit Edi për këtë kontribut të rëndësishëm në fushën e shëndetit publik dhe të mjekësisë në përgjithësi.

Përqafime,

Xhina